REPUBLIKA E SHQIPËRISË
RADIO TELEVIZIONI SHQIPTAR
KËSHILLI DREJTUES NË RTSH

Nr. 2152/4 Prot.

Tiranë, më 19.10.2026

VENDIM
NR. 53 DATË 19.10.2026

Në zbatim të nenit 102, të Ligjit nr. 97, datë 04.03.2013 *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, të ndryshuar, nenit 17 të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, datë 22.12.2016 *"Për miratimin e statutit të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)"*, shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme me nr. 2152/3 prot., datë 16.10.2026, me lëndë *"Për shfuqizimin e vendimit nr. 35, datë 18.04.2017, të Këshillit Drejtues dhe miratimin e një vendimi të ri për trajtimin financiar të punonjësve të RTSH-së që dërgohen me shërbim brenda dhe jashtë vendit."*, si dhe në vijim të procesverbalit të mbledhjes, mbajtur në datë 19.10.2026; nga ku Këshilli Drejtues pas procesit të rregullt të votimit dhe me shumicë votash:

V E N D O S I :

1. Shfuqizimin e Vendimit nr. 35, datë 18.04.2017, të Këshillit Drejtues të RTSH-së, *"Për trajtimin financiar të punonjësve të RTSH-së që dërgohen me shërbim brenda dhe jashtë vendit"*.
2. Të miratojë Propozimet për disa ndryshime në trajtimin financiar të punonjësve të RTSH-së që dërgohen me shërbim brenda e jashtë vendit, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 610, datë 30.07.2026 *"Për Rregullat, Procedurat, Shpenzimet dhe Kompensimin Financiar për Shërbimet Jashtë Vendit të Punonjësve"*, sipas dokumentacionit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Efektet financiare të këtij vendimi shtrihen nga data 01.10.2026.
4. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm për ndjekjen dhe marrjen e masave administrative e financiare për zbatimin e këtij vendimi.

KËSHILLI DREJTUES

Z. Fatjon Hoxhalli	Kryetar	
Z. Petrit Beci	Nënkryetar	
Z. Enio Civici	Anëtar	
Z. Pano Xhixho	Anëtar	(mungon)
Z. Alket Braho	Anëtar	
Znj. Zamira Kita	Anëtar	(mungon)
Z. Lorenc Vangjeli	Anëtar	(mungon)
Z. Bujar Kapexhiu	Anëtar	
Z. Osman Mula	Anëtar	
Znj. Rajmonda Bulku	Anëtar	
Z. Robert Budina	Anëtar	(mungon)